Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohet: Marrëveshja e bashkëpunimit<sup>12</sup> ndërmjet operatorëve ekonomikë.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Kjo shtojce do paraqitet ne fazen e II)*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*
- c. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;*
- ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- d. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*
- dh. *Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim, sipas Shtojcës 15;*
- e. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas shtojcës 11.*
- ë. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;*
- f. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

<sup>12</sup> Ligji nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” neni 14

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*(të plotësohet nga autoriteti përgjegjës),*

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të konfirmuara nga autoriteti perkates, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Shenim-Pika 2.2.2) plotësohet duke paraqitur vërtetimin perkates te Administrates Tatimore .*

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e maturuara të taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2021, sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur.*

*(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të kete vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore 2021 për secilin operator).*

2.3 Për kapacitetin teknik:

1.- Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Operatori ekonomik ofertues për të plotësuar këto kritere duhet të ketë kryer shërbime të së njëjtës natyre me objektin e prokurimit me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

*Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- Kur shërbimi i së njëjtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë:
  - i) kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me:
  - ii) faturat tatimore perkatese të konfirmuara për shërbimet e kryera;
  - iii) vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar;
- Kur shërbimi i së njëjtës natyre është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik duhet të paraqesë: a) faturat tatimore perkatese, të konfirmuara *(ku të shprehën qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)* dhe situacionet për shërbimet e kryera;

## 2.4-Licensa e shoqerise/ofertuesit:

a) Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me liçencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit, për këto arsye duhet të paraqesë licensën perkatese të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit të miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

*PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI*

- N.P – 1 Punime gjurmimi në tokë.
- N.P – 2 Ndertime civile dhe industriale
- N.P – 3 Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile dhe industrial , veshje fasade.
- N.P – 7 Ujesjellesa, gazsjellesa. vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- N.P – 11 Nderime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

*PUNIME SPECIALE NDERTIMI*

- N S – 1. Punime për prishjen e ndertimeve
- N S – 2. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre
- NS–3. Impiante ngritese dhe transportues (ashensore,shkalle levizese,transportues)
- N S – 4. Punime rifiniture të muratures dhe të lidhura me to,rifiniture me materiale druri,plastik,metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyres teknike ndertuese.
- N.S – 8 Ndertime parafabrikat me beton të armuar,struktura metalike dhe druri
- N.S – 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- N.S – 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- N.S – 18 Punime topogjeodezike

Shenim –Licensa duhet të jete lëshuar sipas rregullave të VKM Nr.759 date 12.11.2014 ‘‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’’ i ndryshuar.

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

## 2.5-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik:

2.5.1-Per realizimin me sukses të kësaj kontrate kerkohet stafi i meposhtem teknik i cili duhet të vihet në dispozicion nga ana e Operatorit Ekonomik ofertues si vijon

- a) Ing. Ndertimi (2) –Për të konfirmuar këto kusht kerkohet të paraqitet kontrata e vlefshme e punes, pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates, shoqeruar me diplomën perkatese.
- b) Arkitekt (1) Për të konfirmuar këto kusht kerkohet të paraqitet kontrata e vlefshme e punes pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates, shoqeruar me diplomën perkatese.

- d) Ing Gjeodet (1) ) Per te konfirmuar kete kusht kerkohet te paraqitet kontrata e vlefshme e punes pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates, shoqeruar me diplomën perkatese.
- e) Ing Elektrik (1) Per te konfirmuar kete kusht kerkohet te paraqitet kontrata e vlefshme e punes pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates, shoqeruar me diplomën perkatese.
- f) Ing mjedisi (1) Per te konfirmuar kete kusht kerkohet te paraqitet kontrata e vlefshme e punes pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates, shoqeruar me diplomën perkatese.
- g) Ing hidroteknik (1) Per te konfirmuar kete kusht kerkohet te paraqitet kontrata e vlefshme e punes pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates, shoqeruar me diplomën perkatese.
- h) Ing mekanik (1) Per te konfirmuar kete kusht kerkohet te paraqitet kontrata e vlefshme e punes pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates, shoqeruar me diplomën perkatese.

2.6-Operatori ekonomik /ofertuesi duhet te kete nje punesim mesatar punonjesish prej 12 (dymbëdhjete) punonjesish te nevojshem per sherbimin e kerkuar, per periudhen te pakten 3 muajt e fundit, per te provuar kete pike duhet te paraqitet dokumentacioni si vijon:

- Kjo pike (2.6), provohet duket paraqitur nga ana e OE , vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rajonit perkates ose
- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 025) sipas formatit elektronik ne perputhje me VKM Nr. 922 date 29.12.2014 ”Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”

2.7-Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesi Certifikatat e Standartizimit si vijon te vlefshme :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) E vlefshme (Ne rast te dorezimit te ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO sipas zerave te sherbimeve qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marreveshjes).
- ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) E vlefshme. (Ne rast te dorezimit te ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO sipas zerave te sherbimeve qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marreveshjes).
- OHSAS 18001:2007/ ISO 45001-2018, (të vlefshme) (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) E vlefshme. (Ne rast te dorezimit te ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike , cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO sipas zerave te sherbimeve qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marreveshjes).

*Shënim: Certifikatat e mesiperme/ekuivalentet duhet te jene te leshuara nga Institucione te certifikuara/akredituara ne Shqiperi ose tek ato nderkombetare.*

2.8. Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM Nr.354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”, si dhe në mbështetje të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot ”Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe

*kolaudim” si dhe Rekomandimit te dates 27.06.2018 me Nr. 6559 prot te APP.*

*Shenim-Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM Nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.*

*(Oferta ekonomike do paraqitet ne fazen e II)*

Sqarim për operatorët ekonomikë: Në bazë të ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” si dhe Njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Nr.25366 Prot, datë 30.12.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.8480 Prot, datë 30.12.2020, Autoriteti Kontraktor Bashkia Mirdite informon se për nënshkrimin e një kontrate në përfundim të procedurës, operatori ekonomik duhet të ketë:

- *Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për Tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave.*
- *Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Çertifikuuar për zgjidhjen softwerve-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.*
- Vetedeclarim i postes zyrtare elektronike te subjektit.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 16

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)*

#### PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkengjitur me DST

Grafiku i Punimeve: Eshte per fazen 2

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Eshte per fazen 2

Shtojca 17

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)*

#### PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Eshte per fazen 2

Shtojca 18

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës* ]

#### GRAFIKU I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Kohezgjatja e kontrates ne total eshte 12 muaj.

Eshte per fazen 2

Shtojca 19

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës* ]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>13</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

---

13 Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore



[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Përgjegjës ka shkelur Aktin Normativ gjatë procedurës së prokurimit publik për rindërtimin, atëherë keni të drejtë të ankoheni siç parashikohet në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

Me respekt  
< Emri >

Shtojca 20

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*  
Etj.

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NUIS-it*  
Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NUIS-it*  
Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)  
Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NUIS-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NUIS-it*

Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me \_\_\_\_\_ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 21

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR

[Data

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____	
	<i>(me numra dhe fjalë)</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____	
	<i>(me numra dhe fjalë)</i>

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
 (nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 22

### KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Punët

Neni 1: Qëllimi

- 1.5 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.6 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.7 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi

i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

- 1.8 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.9 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.9 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.10 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.11 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.12 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Përgjegjës dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.13 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.14 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Përgjegjës se Punët janë mbaruar.
- 2.15 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.16 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Përgjegjës lejon kontraktorin në kantier.
- 2.17 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.18 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.19 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.20 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.21 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.22 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kon Përgjegjës traktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për autoritetin përgjegjës.
- 2.23 “Autoritet Përgjegjës” do të thotë Autoriteti Përgjegjës qe është pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- 2.24 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.25 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.26 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.27 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

- 2.28 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.29 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.30 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Përgjegjës i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.3 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.4 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.4 Autoriteti Përgjegjës mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 18 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.5 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.6 Kontraktori duhet të lejojë autoritetin përgjegjës të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Përgjegjës.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.3 Kontraktori dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.4 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Përgjegjës deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Përgjegjës të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Përgjegjës.
- 6.7 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Përgjegjës zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.8 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Përgjegjës në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i

materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Përgjegjës të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

7.7 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

7.8 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

7.9 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.10 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

8.4 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Përgjegjës.

8.5 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

9.3 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

10.2 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin përgjegjës siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Përgjegjës

11.5 Autoriteti Përgjegjës ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Përgjegjës ose të projekteve të Autoritetit Përgjegjës me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

12.1 Autoriteti Përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Përgjegjës, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoritetit Përgjegjës.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Përgjegjës.



## Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.
- 14.2 Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi duhet të koordinojë me kontraktorët e tjerë zbatues në vendodhjen e punimeve sipas metodës që do të propozojë me qëllim ecurine dhe zbatimin brenda afatit të kontratës.
- 14.3 Kontraktori duhet të paraqesë planin e koordinimit tek drejtuesi i projektit për shqyrtim dhe miratim të tij.

## Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

## Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

## Neni 17: Zbulimet

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

## Neni 18: Disponimi i Kantierit

- 18.1 Autoriteti Përgjegjës duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Përgjegjës ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Përgjegjës dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

## Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

- 19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.
- 19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

## Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

- 20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

## Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

- 21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
- 21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Përgjegjës.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Përgjegjës do të jetë përgjegjës për:

(a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Përgjegjës apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Përgjegjës, përveç kontraktorit.

(b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Përgjegjës apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Përgjegjës sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Përgjegjës dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumatat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Përgjegjës, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Përgjegjës.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Përgjegjës me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin përgjegjës për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

26.3 Autoriteti Përgjegjës gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Përgjegjës do të mbajë

përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Përgjegjës do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Përgjegjës do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27: Garancitë

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 29: Kushtet e Pagesës

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përmbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korigjimit të një defekti.

29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Përgjegjës.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Përgjegjës, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të

rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës

Neni 32: Forca Madhore

- 32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.
- 32.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Përgjegjës, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Përgjegjës jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

